



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:040275

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06727358

C-IV.-18-0038

Ankuesi:

FL përfaqësuar nga *B Iavokat nga Prishtina.*

Kundër:

E paditura:

N.SH “PMN Sharr”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.17 janar 2025, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. HUDHET ankesa e ankuesit si e pa bazuar e paraqitur kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.30 prill 2018, ankuesi ish punëtor i NSH “PMN Sharr” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit, me të cilën ka kërkuar kompensim të dëmit jo material (dëmtim dhe rrezikim i shëndetit nga puna me azbest).

Me dt.07 gusht 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se ankesa e kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitje të kërkesave. AKP me dt.01 prill 2011, kishte shpallur njoftimin publik me anë të së cilit janë njoftuar të gjithë kreditorët potencial

por edhe palët e interesit si dhe opinioni i gjerë për afatin për paraqitjen e kërkesave apo pretendimeve. Ky afat kishte filluar me dt.22 shkurt 2011 dhe kishte përfunduar me dt.28 mars 2011. Padiësi vetëm me dt.10 mars 2014, ka parashtruar kërkesën (kërkesa kolektive për 61 ish punëtorët e ndërmarrjes), pranë zyrës rajonale në Gjilan. Në mesin e tyre ishte edhe padiësi i cili për herë të parë e paraqet pretendimin e tij për kompensim në emër të sëmundjes profesionale nga marrëdhënia e punës. Ka kërkuar që kërkesëpapia e padiësit të hedhet si e pa pranueshme.

Arsyetimi ligjor

Ankesa hudhet si e papranueshme .

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH “PMN Sharr” kishte hyr në proces të likuidimit dhe AKP kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH “PMN Sharr” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me dt.28 mars 2011.

Gjykata gjen se padiësi vetëm me dt.10 mars 2014, ka parashtruar kërkesën (kërkesa kolektive për 61 ish punëtorët e ndërmarrjes), pranë zyrës rajonale në Gjilan.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKP-ja. Ankuesi në ankesë nuk ka sjell asnjë provë apo dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit, mandej nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 28 mars 2011, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës në Autoritetin e Likuidimit, ankuesi ka kaluar 3 vite vonesë të pajustificuar. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është konsideruar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme hudhet si e papranueshme duke gjetur se i mungon vendimi ndaj të cilit është dashur të ushtrohet.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Bazuar në rrjedhën e kësaj procedure dhe në shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi nuk e ka përmbush kriterin e paraparë me nenin 36 .2.2.6 i cili parasheh se “një ankesë është e pranueshme nëse është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa /ankesa” .

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.02 qershor 2018.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Hajrie Shala